



VENDIM

Nr. 83, Datë 07.06.2017

MBI

FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E DRAFT-RREGULLORES SË PROCEDURAVE PËR LIDHJET E REJA DHE MODIFIKIMIN E LIDHJEVE EKZISTUESE ME RRJETIN E TRANSMETIMIT; MARRËVESHJES SË OPERIMIT NË RRJETIN E TRANSMETIMIT NDËRMJET OST SH.A. DHE PËRDORUESIT SI DHE MARRËVESHJES SË LIDHJES NË RRJETIN E TRANSMETIMIT NDËRMJET OST SH.A. DHE PËRDORUESIT

Në mbështetje të neneve 16, 21, 27 dhe 28 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; “Kodit të Transmetimit”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 123, datë 31.10.2008, dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.06.2017 mbasi shqyrtoi kërkesën e Shoqërisë “OST” sh.a., për miratimin e “Rregullores së Procedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit, Marrëveshjes së Operimit në Rrjetin e Transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe Përdoruesit si dhe Marrëveshjes së Lidhjes në Rrjetin e Transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe Përdoruesit,

Konstatoi se:

- Me shkresën nr. 2350 prot., datë 28.04.2017, OST sh.a. ka dërguar në ERE kërkesën për miratimin e Rregullores së Procedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit, Marrëveshjen e Lidhjes si dhe Marrëveshjen e Operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe Përdoruesit.
- Kjo Rregullore si dhe Marrëveshjet standarte të lidhjes bashkëlidhur saj, bazohen në nenet 21, 27 dhe 28 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në Kodin e Transmetimit, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 123, datë 31.10.2008.

- Në nenin 27 pika 3 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” parashikohet se, është OST sh.a., në cilësinë e të licencuarit, i ngarkuar me detyrimin e hartimit të kësaj rregullore dhe ERE ka autoritetin për miratimin e saj.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për miratimin e Draft-Rregullores së Procedurave për Lidhjet e Reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit; Marrëveshjes së Operimit në Rrjetin e Transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe Përdoruesit si dhe Marrëveshjes së Lidhjes në Rrjetin e Transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe Përdoruesit.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a., si dhe palët e interesuara për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të ERE-s për,
VENDIMIN
Nr. 83, Datë 07.06.2017

MBI
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E DRAFT-
RREGULLORES SË PROCEDURAVE PËR LIDHJET E REJA DHE
MODIFIKIMIN E LIDHJEVE EKZISTUESE ME RRJETIN E
TRANSMETIMIT; MARRËVESHJES SË OPERIMIT NË RRJETIN E
TRANSMETIMIT NDËRMJET OST SH.A. DHE PËRDORUESIT SI
DHE MARRËVESHJES SË LIDHJES NË RRJETIN E
TRANSMETIMIT NDËRMJET OST SH.A. DHE PËRDORUESIT

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kund r
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____